



## Dhuratë e bukur:


DigitalSTROM tregon aplikimet e Smart Home për parandalimin dhe mbrojtjen nga vjedhjet.

Festat e fundvitit për shumëkënd janë periudha më e mirë e vitit. Por qetësia gjithnjë e më tepër do të priset, sepse javët në prak të Vitit të Ri janë veçanërisht të popullarizuara me vjedhësit.

Statistikat thonë se thyerjet gjatë dimrit janë dyfish më të shpeshta se në muajt e verës. Hajdutët jo vetëm që përdorin errësirën e hershme, por edhe zhurmën e banorëve të shtëpive. Po gjatë kësaj kohë edhe shumë shtëpi mbesin të zbrazura për shkak të festimeve, tregut dhe ftesave. Mirë do të ishte sikur shtëpia të ishte mjaft inteligjente dhe të kujdesej për veten! Falë aplikimeve inovative dhe shërbimeve, katërmuret mund të jenë efektive për të parandaluar vjedhjet. DigitalSTROM, ofruet një zgjidhjeje të Smart Home, ka bashkuar aplikacionet më të efikase të sigurisë në mënyrë që sezoni i fundvitit të mos përfundojë me tmerr e horror.



**DIMRI SI PËRRALLOR PËR HAJDUTËT:** Dendësia e thyerjeve të shtëpive është shumë e lartë. Dy të tretat e të gjitha vjedhjeve ndodhin në mbrëmje, sepse në errësi hajdutët e kanë lojën më të lehtë. Në kohën e dimrit, rreziku është veçanërisht i madh: kur herët errësohet dhe kur pas orarit të punës vazhdohet me tregun, shtëpia e vetmuar është shumë tërheqëse për gishtgjatët. Dëmi material ka pasoja edhe me sigurimin dhe shoqërohet edhe me pasojat psikologjike të një vjedhjeje, ata që preken shpesh vuajnë për një kohë të gjatë. Prandaj parandalimi efektiv është veçanërisht i rëndësishëm. Përveç teknologjisë efikase të sigurisë në dyer e dritare si dhe në vetë ndërtesën, është e rëndësishme që mungesa e banorëve të mos identifikohet asnjëherë.



**SHTËPIA DUKET E BANUAR:** Jo të gjithë janë po aq kreativ në mbrojtjen e shtëpisë nga hajdutët sikur te rasti i filmit klasik "Kevini vetëm në shtëpi".

Një simulim i zgjuar i prezencës mund të ndihmojë këtu. Duke rrjetëzuar të gjitha pajisjet elektrike në shtëpi, është e mundur të imitojmë ritmin ditor të banorëve: roletat lëshohen poshtë e ngrihen lartë ose ndezen dritat e Vitit të Ri ose lëshohet muzika nga sistemi. Të gjitha aplikimet mund të kontrollohen nga kudo përmes pajisjeve mobile – pavarësisht se ku mund të gjendeni për momentin. Këta skenarë të prezencës reale ndihmojnë në tmerrimin e hajdutëve dhe për të penguar thyerjet potenciale.

**GJITHMONË NËN KONTROLLË:** Para nisjes për në pushimet e dimërore është harruar drita në dhomë të gjumit?

Me rrjetin inteligjent të shtëpisë mund të kontrollohet gjithmonë në lëvizje nëse çdo gjë është në rregull në shtëpi. Një vështrim në smartfon është i mjaftueshëm: Pasqyra e konsumimit në aplikacionin e Smart Home zbulon nëse dritat ende konsumojnë energji. Me vetëm një klik mund të fiket drita e harruar – pa marrë parasysh vendndodhjen. Kush integron në rrjetin shtëpiak një detektor lëvizjeje dhe një kamerë, ai merr madje si dëshmi edhe një fotografi. Nëse aktivizohet detektori i lëvizjes, kamera dërgon një imazh me e-mail në celular. Banori është në gjendje të gjejë nëse një hajdut ka fituar qasje ose gjyshja po viziton mbesën e nipin.



Një Smart Home gjithashtu ofron një standard të ri të sigurisë falë aplikimeve inteligjente. Shtëpia inteligjente është në gjendje të inkorporojë të gjithë teknologjinë e brendshme të sensorëve në analizën e alarmit – mundësuar nga rrjetëzimi i të gjitha pajisjeve në amvisëri. Pra, sistemi e di nëse është fjala për një alarm të vërtetë kur godet detektori i lëvizjes dhe kur nuk është askush në shtëpi. Një mesazh në telefon njofton pronarin për incidentin dhe lejon veprim të shpejtë. Teknologjia Smart Home kontrollon pjesën më të rëndësishme për të mënjeluar dëmet.



**TMERRI PËR HAJDUTËT:** Nëse Smart Home identifikon një alarm si të vërtetë, ai madje mund të mbrojë veten – me të ashtuquajturin Panik-Taster. Me aplikimin, i cili mund të aktivizohet nëpërmjet butonit në shtëpi ose nëpërmjet App nga rruga, ndizen të gjitha dritat dhe emitohet një signal akustik nga sistemi audio për të tmerruar hajdutin dhe për t'ia dhënë ai vrapim në kërkim të shpëtimit të vet.



Përdoruesit e DigitalStrom-it jo vetëm mund të presin një mbrojtje më të mirë kundër hajdutëve. Sapo të instalohet njëherë sistemi, shtëpia inteligjente gjithashtu ofron një plus të qartë në komoditetin e jetesës dhe efikasitetin e energjisë - sidomos në sezonin e ftohtë në sajë të kontrollit inteligjent të ngrohjes. Dhe, aftësia për të krijuar skenarë fantastik të dritës me shoqërim muzikor me një prekje të butonit për të krijuar ambiente të këndshme, të cilave njeriu nuk u gëzohet vetëm për festat e fundvitit, por mbetet në përjetim i përherëshëm në çdo kohë.